



FTESE PER OFERTE

Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve është organizatë joqeveritare e përkujdesjes sociale e dedikuar për përkrahjen e fëmijëve të braktisur dhe në nevojë, pa marrë parasysh etninë, kombësinë dhe besimin fetar.

SOS Fshatrat e Fëmijëve duke përfshirë të gjithë projektet në kuadër të organizatës, fton ofertuesit e specializuara dhe të interesuara për një sallë të mjaftueshme, për realizimin e trajnimeve, seminareve, si dhe për aktivitete tjera. Kjo sallë do të përdoret për të përmbushur aktivitetet e planifikuara gjatë vitit që do të ofrojnë mundësi për zhvillim profesional të punonjësve, shkëmbimin e përvojave me partnerë dhe bashkëpunëtorë, zgjerimin e partneriteteve dhe promovimin e punës së organizatës.

Me këtë rast ju bëjmë Ftesë për Ofertë sipas specifikacionit në vijim:

- Sallë trajnimi e cila ka kapacitet për 20-50 persona
- Salla të jetë e përshtatshme për punë në grupe, session plenar apo format tjetër
- Ofrimi I ujit (2 shishe të vogla) për pjesëmarrës gjatë trajnimit
- Ofrimi I kafes (3 kafe) për pjesëmarrës gjatë pauzave
- Dreka për pjesëmarrës (ju lutem të bashkangjisni menynë në përbërje: supe, sallatë, pijata kryesore, desert dhe nje uje)
- Salla të ketë kushte për punë sa i përket ndriçimit, pastërtisë dhe qetësisë;

E gjithë hapësira e ofruar duhet të jetë në përputhje me respektimin e masave të marra sipas Manualit për mbrojtje nga COVID-19 nga Qeveria e Kosovës.

Salla duhet të jetë e pajisur me:

- Internet të shpejtë;
- Ndriqim dhe ajrosje natyrale;
- Projektor;
- Tabelë për mbajtjen e letrave (flipchart);
- Mundësi për printim (e preferuar).
- Salla duhet të jetë me lokacion në Prishtinë dhe jo më larg se 10 km nga qendra e Prishtinës.

Dokumentet e nevojshme:

1. Certifikata e regjistrimit të biznesit/ NUI
2. Cmimet e kuotuar në euro pa tvsh
3. Oferta financiare e ndarë me cmime për: sallë, ujë, kafe dhe drekë
4. Oferta financiare e nënshkruar ose me llogo zyrtare

Kriteret për përzgjedhjen e ofertës më të mirë do të jenë si në vijim:

1. Përmbushja e specifikacionit sipas Ftesës për Ofertë
2. Pas plotësimit të specifikacionit të cekur si më lartë - Çmimi më i lirë

Vlefshmëria e Ofertës duhet të jetë 30 ditë nga data e mbylljes së Ftesës për Ofertë.

Ofertuesi i përzgjedhur, para nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës dhe pronari nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe vërtetimin tatimor.

Ofertuesit e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet dhe ofertën e mbyllur në pliko (zarf) 2 kopje të nënshkruara nga përfaqësuesi ligjor dhe të shënuara me kodin: "Oferta për Sallë". Ofertat duhet të dorëzohen deri me datën: 30.08.2021 në zyrat e SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, në adresën Velania 1 Tetori p.n. Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00. Ofertat e pakompletuara dhe të dorëzuara me vonë nuk do të shqyrtohen.